

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

A. K. [REDACTED]
PML 64/2014

Data: 3 prill 2014

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti si kryetar i kolegjit, gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës Sali Toplica si anëtarë të kolegjit, në prani të Zyrtares ligjore të EULEX-it Natalie Dawson, duke vepruar në cilësi të procesmbajtëses, në lëndën kundër të pandehurit:

A. K. [REDACTED] emri i babait [REDACTED] emri i nënës [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED] tani me vendbanim në Prishtinë, numri i letërnjoftimit [REDACTED] i arrestuar më 28 tetor 2013.

I dyshuar për kryerjen e veprave penale në vijim:

- **Krim i organizuar** në shkelje të nenit 283, paragrafit 2 të KPRK-së, në lidhje me veprën penale **Detyrim** në shkelje të nenit 340, paragrafit 2 të KPRK-së;
- **Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve** në shkelje të nenit 374, paragrafit 1 të KPRK-së.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Dr. I. R. [REDACTED] avokat, në emër të pandehurit A. K. [REDACTED] të datës 17 mars 2014.

Pas leximit të përgjigjes së Prokurorit Special të datës 2 prill 2014, mendimit të Prokurorit të Shtetit, të paraqitur më 1 prill 2014, pas këshillimit dhe votimit në seancën e mbajtur më 4 prill 2014, sipas neneve 451, 454 dhe 455 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje KPP), lëshon si në vijim.


Pas këshillimit dhe votimit, sipas nenit 435 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), Gjykata Supreme lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të pandehurit A. K. [REDACTED] e datës 17 mars 2014, e paraqitur në emër të tij nga avokati mbrojtës Dr. I. R. [REDACTED] REFUZOHET SI E PABAZUAR.

ARSYETIM

A. Historia e procedurës:




1. Më 8 mars 2013, Prokurori Special ka lëshuar aktvendimin mbi fillimin e hetimeve kundër të pandehurit [redacted] dhe të bashkëpandehurve [redacted] dhe [redacted] A.N. A.K.I. A.K.2.
2. Të gjithë të pandehurit janë arrestuar më 28 tetor 2013 dhe në të njëjtën ditë Prokurori Special ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit kundër tre të pandehurve.
3. Më 29 tetor 2013, Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka caktuar paraburgimin prej një muaji. Urdhri është vërtetuar nga Gjykata e Apelit më 2 nëntor 2013. Rrjedhimisht, paraburgimi është vazhduar me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të lëshuar më 27 nëntor 2013, i cili është aprovuar nga Gjykata e Apelit më 6 dhjetor 2013, dhe pastaj me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 11 shkurt 2014 deri më 26 prill 2014.
4. Në aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të 11 shkurtit 2014 theksohet se nuk ka pasur ndryshime të rrethanave që nga caktimi fillestar i paraburgimit dhe vazhdimet e mëparshme. Aktvendimi ka gjetur se:
 - a. Ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat dyshohen.
 - b. Ekzistojnë arsye të mjaftueshme të besohet se të pandehurit do t'i frikësojnë dëshmitarët dhe nëse lirohet do ta bëjnë të ditur identitetin e dëshmitarëve
 - c. Të pandehurit do të mund të kontaktojnë anëtarët e tjerë të grupit kriminal dhe dëshmitarë e tjerë të cilët ende nuk janë identifikuar.
 - d. Ekziston rreziku i arratisjes sepse të pandehurit [redacted] dhe [redacted] kanë lidhje në Austri. A.K.I. A.K.2.
 - e. Ekziston rreziku i përsëritjes së veprave penale për shkak të vazhdimësisë së veprave të pretenduara penale.
 - f. Masat alternative nuk i eliminojnë këto rreziqe.
5. Aktvendimi është mbështetur nga Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj të datës 1 mars 2014.
6. Avokati mbrojtës duke vepruar në emër të pandehurit [redacted] A.K.I. ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit më 1 mars 2014.

B. Qëndrimet e palëve:

a. Avokati mbrojtës:

- i. Gjykata e Apelit nuk ka qenë e përbërë në mënyrë të duhur. Kryetari i kolegjit, gjyqtari Bertil Ahnborg është përjashtuar nga pjesëmarrja në këtë këshillim për shkak të përfshirjes së tij të mëparshme në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, të vendosur më 11 shkurt 2014.
- ii. As aktvendimi i Gjykatës së Apelit e as aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake nuk përshkruajnë asnjë veprim kriminal të kryer nga i pandehuri A.K.I. [redacted] Pretendimet kundër tij janë të fabrikuara.
- iii. Masat më të buta do të mjaftonin në këtë lëndë në pritje të gjykimit.



b. Prokurori i Shtetit:

- i. Gjykata Supreme duhet ta anulojë aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe ta kthej lëndën për një vendim të ri.
- ii. Gjyqtari Bertil Ahnborg është përjashtuar për shkak të pjesëmarrjes së tij të mëparshme dhe për këtë arsye është bërë shkelje e procedurës. Kjo shkelje nuk është esenciale pasi që avokati mbrojtës thjesht përsërit çështjet të cilat tanimë janë trajtuar.
- iii. Arsyet tjera janë pa merita pasi që nuk ka pasur ndryshime të rrethanave dhe nuk janë paraqitur arsye të reja.

c. Përgjigja e Prokurorit të PSRK-së

- Gjyqtari Ahnborg nuk është përjashtuar. Përfshirja e tij e parë ka qenë si gjyqtarë në shkallën e tretë, që ka pasur për detyrë të shqyrtoj vetëm çështjet procedurale. Përfshirja e tij e dytë ka qenë si gjyqtar i shkallës së dytë. Këto janë procedura të ndara.
- Nëse gjykata nuk e konsideron këtë argument në favor, Prokurori do të parashtroj se vendimi duhet të anulohet dhe të kthehet në Gjykatën e Apelit.


C. Gjetjet e gjykatës:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur me kohë dhe nga personi i autorizuar.

1. Qëndrimi i gjyqtarit Bertil Ahnborg – çështja e përjashtimit

A. K. I.

- a. I pandehuri [REDACTED] dyshohet për kryerjen e veprave penale Krim i organizuar në lidhje me veprën penale Detyrim dhe Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Procedura penale kundër [REDACTED] është në pritje në fazën e hetimeve; aktakuza nuk është ngritur akoma. Të gjitha aktvendimet relevante të mëparshme në këtë lëndë kanë pasur të bëjnë vetëm me caktimin apo vazhdimin e paraburgimit. Prandaj, patjetër duhet vërejtur se, vlerësimi i çështjes së përjashtimit tani ka të bëjë vetëm me vendimet mbi paraburgimin gjatë fazës së hetimeve të procedurës penale dhe në nivelin e apelit.
- b. Përfshirja e parë e gjyqtarit Ahnborg's në këtë lëndë ka qenë si gjyqtar në shkallë të tretë (Gjykatën Supreme) më 11 shkurt 2014, duke kryesuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Kjo ka qenë në lidhje me aktvendimi e Gjykatës Themelore më 27 nëntor 2013, kur gjyqtari i procedurës paraprake ka vazhduar masën e paraburgimit. Përfshirja e dytë e gjyqtarit Ahnborg's në këtë lëndë ka qenë si gjyqtar në shkallë të dytë më 1 mars 2014, duke kryesuar kolegjin e Gjykatës së Apelit në lidhje me ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore më 26 shkurt 2014, kur gjyqtari i procedurës paraprake ka vazhduar masën e paraburgimit për herë të dytë.



- c. Neni 39(2) i KPP-së përcakton si në vijim:


'Gjyqtari përjashtohet si... anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal ...'.

- d. Avokati mbrojtës pretendon se gjyqtari Bertil Ahnborg është përjashtuar nga pjesëmarrja në vendosjen e ankesës në Gjykatë e Apelit më 1 mars 2014. Gjatë zbatimit të kësaj dispozite në këtë lëndë kolegji konstaton se formulimi i nenit 39(2) të KPP-së është aq i përgjithësuar saqë ka nevojë për interpretim. Kolegji përfundon se patjetër duhet të përcaktohet qëllimi i ligjvënësit.
- e. Dispozita ekuivalente në ligjin e mëparshëm (neni 40(1)(5)) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës që ka qenë në fuqi deri më 1 janar 2013) përcakton si në vijim:

'Gjyqtari ... përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur:

(5) Në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët ose nëse në gjykatën e njëjtë ka marrë pjesë në marrjen e vendimit i cili kundërshtohet me ankesë.'

- f. Kolegji konsideron se dispozita e vjetër në mënyrë të qartë përcakton se gjyqtari në nivelin e apelit është përjashtuar nga pjesëmarrja në gjykimin e një lënde nëse ai ka marrë pjesë në marrjen e vendimit të kundërshtuar. Natyra e përgjithshme e formulimit të nenit ekuivalent sipas kodit të ri (neni 39(2)) i jep kolegjit arsye që të besoj se ligjvënësi nuk ka pasur për qëllim që ta ndryshoj këtë rregull.
- g. Duke pasur parasysh këtë, kolegji përfundon se qëllimi i qartë i nenit 39(2) të KPP-së është që t'i shmangemi gjyqtarit i cili ka formuar mendim në lidhje me meritat e lëndës - duke pasur parasysh këtë, dhe duke arritur në përfundim, informatat në dispozicion të gjykatës në kohën përkatëse në lidhje me rrethanat e të pandehurit dhe provat në lidhje me veprat e dyshuara penale për të cilat akuzohen, të cilat janë relevante për statusin e paraburgimit të të pandehurit— nga pjesëmarrja në gjykimin e lëndës në nivel më të lartë. Nëse një gjyqtar i tillë është lejuar që ta gjykojë lëndën në nivel më të lartë, i pandehuri do të privohej nga mundësia e tij për një vendim ndryshe dhe të drejtat e tij do të shkeleshin. Ky gjithashtu është mendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në jurisprudencën e saj.
- h. Prandaj, gjyqtari i apelit nuk përjashtohet nga vendosja e ankesës kundër vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake mbi paraburgimin, edhe nëse ai paraprakisht ka marrë pjesë në lëshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit që ka të bëjë me aktvendimin e mëparshëm të gjyqtarit të procedurës paraprake mbi paraburgimin në të njëjtën lëndën penale në pritje në fazën e hetimeve kundër të pandehurit të njëjtë. Kolegji thekson se rrethanat e tilla përfshijnë ankesa të ndara kundër vendimeve të ndara.




- i. Trajtimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kërkon nga gjyqtari që të shqyrtoj vetëm formalitetet procedurale dhe shkeljet e pretenduara të ligjit penal në kuadër të aktvendimit të kundërshtuar. Nuk kërkohet nga gjyqtari që ta krijoj mendimin e tij në lidhje me meritat dhe provat e lëndës.
- j. Duke i marrë parasysh këto pika, kolegji gjen se gjyqtari i Gjykatës Supreme përjashtohet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nëse ka marrë pjesë në marrjen e aktvendimit të kundërshtuar. Sidoqoftë, gjyqtari i cili ka vepruar si Gjyqtar i Gjykatës Supreme në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me vendimin e mëparshëm mbi paraburgimin nuk përjashtohet nga vendosja e ankesës vijuese (si gjyqtar i Gjykatës së Apelit) gjatë fazës së njëjtë të hetimeve. Në rrethana të tilla të pandehurit nuk i privohet e drejta për një gjykim të paanshëm.
- k. Kolegji konstaton se gjyqtari Ahnborg nuk është përjashtuar nga rrethanat e referuara në këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.
- l. Së pari, kolegji gjen se dy vendimet e referuara në këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë janë, e para, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe e dyta, ankesë. Këto janë dy vendime të ndryshme, prandaj janë dy raste të ndara në nivel të apelit.
- m. Së dyti, pasi që përfshirja e parë e gjyqtarit Ahnborg në procedurën penale kundër të pandehurit [redacted] ka qenë në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, kolegji konstaton se nuk ka asnjë indikacion i cili tregon se ai ka shqyrtuar dhe ka krijuar një përfundim personal në lidhje me meritat e kësaj lënde. Prandaj, kolegji gjen se kur gjyqtari Ahnborg ka marrë pjesë në vendosjen e ankesës më 1 mars 2014, ai ka qenë i lirë dhe në gjendje që të shqyrtoj dhe arrij në përfundim personal në lidhje me meritat e ankesës. Më 1 mars 2014, gjyqtari Ahnborg nuk është përjashtuar dhe të drejtat e pandehurit nuk janë shkelur.

2. Meritat e kërkesës

- a. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i datës 1 mars 2014 është i qartë se ankesa nuk përmban asnjë informatë të re për ta bindur kolegjin se gjyqtari i procedurës paraprake ka gabuar kur ka vazhduar paraburgimin në lidhje me të pandehurin [redacted] A.K. 1.
- b. Pas shqyrtimit të aktvendimeve të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, Gjykata Supreme gjen se aktvendimi i Gjykatës së Apelit përmban përshkrim të mjaftueshëm të pretendimeve me të cilat ballafaqohen të pandehurit. Prandaj, kolegji konstaton se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ligjore.

Prandaj, kolegji refuzon kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar në dy bazat.



Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtëse:

Timo Vuojolahti
Gjyqtar i EULEX-it


Natalie Dawson
Zyrtare ligjore

Anëtarët e kolegjit:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Sali Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML 64/2014
3 prill 2014



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TACNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašteni radnik

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Gjermani'.